



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.50/2013

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Mihane Miftari, në çështjen penale ndaj të pandehurit nga fsh. Komuna e Mitrovicës, nën dyshimin për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-es, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm PP.nr. 2011, dt.22.02.2013, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Fikrije Sylejmani në prezencë të të pandehurit pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publike në praninë e të pandehurit, në bazë të nenit 359, 360, 361, 356, 366 të KPP-se, me dt.03.09.2014, muarrë dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.04.09.2014;

AKTGJYKIM

I akuzuari;

nga i ati , e ëma , e vajezerise , i lindur me 14.12.1979, me vendbanim në fsh. Komuna e Mitrovicës, me nr. personal , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes ekonomike i dobët.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE;

Me dt.12.06.2011 rreth orës 14:00 min, në Pyllin Shoqëror që menaxhohet nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve Sektori i Pylltarisë Zyra në Mitrovicë në vendin e quajtur Barel-Udha e Goldes në pyllin publik me qëllim ka prerë dhe ka marrë 18 cope trungje të llojit ahu, me diametër 20cm me vëllim prej 4.86m³, me këtë i ka shkaktuar dëm palës së dëmtuar.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-es,

Andaj Gjykatat në baze të nenit 4, 7, 17, 21, 46, 73 të KPRK-es dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-se e;

GJYKON

Më DENIM ME GJOBË në shume prej katerqindeuro (400€) të cilin dënim do të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi.



Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në baze të nenit 46 të KPRK-se, deri në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur, 20 € për një ditë të kaluar me burg.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të jenë sipas listës definitive, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili të paguaj shumën prej nga 20€, në afat prej 15 ditësh nga plotefuqishmeria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm

Pala e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo-juridik.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i përgjithshëm, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.nr. 2011, dt.22.02.2013, ndaj të pandehurit nga fsh. Komuna e Mitrovicës për veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-es.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, ka prezantuar Prokuroria e Shtetit Fikrije Sylejmani, i pandehuri dhe pas konstatimeve se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës është vazhduar me mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 246 par.1 të KPP-es, pas deklarimeve të të pandehurit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurores së Shtetit Fikrije Sylejmani, ku pas kësaj i pandehuri ka deklaruar se e kupton aktakuzën dhe pas bindjes së gjyqtarit se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm, ku i pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barë sipas aktakuzës.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat e pranimit të fajësisë së vepra penale Vjedhje pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-es, se dënimi për këtë veprë ligji e ka përcaktuar se është e dënueshme me dënim me gjobë apo me burgim deri në një vit, duke e njoftuar se sipas nenit 383 par.2 të KPP-es, në rast të pranimit të fajësisë nga i pandehuri i njëjti nuk e ka të drejtën e ushtrimit të ankesës për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jjo të plote të gjendjes faktike, po ashtu njofton se në rast të pranimit të fajësisë nuk procedohen provat materiale ndërsa pranimin e fajësisë gjykata do ta vlerësojë si rrethane lehtësuese në rastin e matjes së dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merret gjykata me rastin e matjes së dënimit, dhe i pandehuri qëndron pranë pranimit të fajësisë.

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me deklarinimin e të pandehurit për pranimin e fajësisë, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është i vullnetshëm dhe pa imponim, mbështetet mbi faktet e çështjes mbi të cilat është ngritur kjo aktakuze andaj i propozojmë gjykatës të e pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pas kësaj gjyqtari është i bindur se i pandehuri e kupton natyrën e pranimit dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk



baze te
m duke

listës
ne
it te

përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj Gjyqtari në procesverbal në kuptim të nenit 248 par.4 të KPP-es, ka marrur aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështet në provat materiale.

I pandehuri pas pranimit të fajësisë i ka propozuar gjykatës që të me shqiptoj një dënim me të bute pasi që jam në një gjendje të dobët ekonomike dhe nuk jam në mardhenje pune dhe që me nga ai vit me nuk kam ndërmarr veprime që të beje prerjen e druve në mënyrë të paligjshme.

Pasi që Gjykata ka pranuar pranim të fajësisë nga ana e të pandehurit dhe me që nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës gjyqtare i çështjes e ka shpallur përfundimin e këtij shqyrtimi dhe i ka njoftuar palët se Gjykata ka vazhduar në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-es me shqiptimin e dënimit – respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë, shpallja ka qenë e hapur dhe publike, në prezencë të pandehurit, ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit, dhe mbrojtësit po ashtu pala-et janë udhëzuar edhe për të drejtën në ankesë.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i pandehuri në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-es, gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të pandehurit kemi të bëjmë me elemente të veprës penale me të cilën akuzohet, kjo vërtetohet nga fletëparaqitja për demtimin e pyllit nr 7/2011, dt.13.07.2011, kërkesën për ngritjen e procedurës dt.30.11.2011 nga vete deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë, andaj të gjitha këto vërtetohen rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përbushen – krijohen elementet e veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-ës, të gjitha rrethanat si me lartë tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-ës, duke i shqiptuar dënim me gjobe, si rrethanë lehtësuese morri pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, gjendjen e dobët ekonomike, si rrethana rënduese gjykata vlerësoi mënyrën e veprimeve të tij në shkaktimin e demtit palës së dëmtuar dhe mbi bazën e kësaj të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, pasi që me këtë dënim pritet që të arrihet qëllimi i ndeshkueshmierisë e përcaktuar me ligj sipas nenit 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalohet kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij dhe se të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, duke vlerësuar se i pandehuri do të përmbahet nga veprime të paligjshme, në mos shkaktimin e demtit me veprime të natyrës së njëjtë, në të kundërtën gjykata e ka njoftuar me pasojat ligjore, andaj gjykata ka vlerësuar se edhe me një dënim të tillë do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i parapare me ligj, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë në mënyrë publike në prezencë të të pandehurit ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit, dhe të mbrojtësit edhe me udhëzimin për të drejtën në ankesë dhe në kuptim të nenit 368 par.1 të KPP-es.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e muar konform neneve 450 dhe 451 të KPP-ës, ndërsa udhëzimi i palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u mbështet në nenin 463 të KPP-es,

3J

pasi qe te dhënat e mbledhura nuk kane paraqitur baze te sigurt për gjykimin e pl
sa i përket kërkesës pasurore juridike pasi dhe se gjykata nuk mund qe te e
kërkesën pasurore juridik duke u mbështetur vetëm ne pretendimin e palës se dër
nje ekspertize nga ekspert i pavarur, andaj Gjykata te dëmtuarën e ka udhë
kërkesën pasurore juridike mund te realizojnë ne kontestin civilo-juridik ne mbës
nenit 463 te KPP-es.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.50/2014, dt.03.09.2014

Procesmbajtësja
Mihane Miftari

M. Miftari



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej
(pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit te këtij aktgjyk
përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.